~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

# KOMANDANT ZAHIR PAJAZITI

▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼
~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

***Shkruan:Fatmir Brajshori***

▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼

## PËRCAKTIMI POLITIK

Arsyeja është shkalla më e lartë e veprimtarisë njohëse, të njeriut për të zhdukur thelbin e dukurisë së zbulimit dhe burgosjes së individëve dhe të grupeve të organizuara, për rrënimin e shtetit dhe për çlirim dhe bashkim të popullit shqiptarë. Arsyeja për Zahirin ishte mendja në kundërvenie me ndjenjën....

Lëshimet politike të subjekteve të organizuara politike ishin bërë për shkak se kërkesat politike nuk ishin përcaktuar edhe forcën e organizuar politike... Ai mendonte që" nëse nuk bëhet kështu, atëherë partitë politike shqiptare në Kosovë do të bëhen përçues të politikës jugosllave dhe ky është përcaktimi i politikës fatale (LDK) për kombin shqiptarë...Ata do ta mësojnë popullin shqiptarë me politiken e kulaçit e kërbaqit, që do të thotë herë me të mirë e me premtime, herë me kërcenime, me shtrengim e me dhunë.

Kjo është politikë e ROBIT DHE KUNDËR SAJ U DEKLARUA ZAHIR PAJAZITI...

Zahiri përcaktoi orientimin e Lëvizjes Çlirimtare. Orientimin e bëri edhe në rrethana të ngatërruara. Nuk e hutuan partitë politike LEGALE që vepronin në Kosovë, të cilat e mobilizonin dhe orientonin popullin për durim.

Kjo do të thotë se kërkonin nga populli durimin e dhembjeve e të fatkeqësive, e vuajtjeve pa shqetsime, pa u ankuar e pa u ligështuar, për plaçkitjet, torturat, burgosjet e bijëve dhe bijave të tij...vrasjet dhe krimet e pafund...

Funeralet ku merrnin pjesë me dhjetra mijëra, i lejonte Serbia por udhëheqja politike nuk ishte aty, me popull, por me durim ftonte se " hazër është selameti", por nuk e ndienin se për popull kishte ardhur Kijameti..
Kjo veprimtari, ky orientim nga Zahiri kurrë nukk mori PËRKRAHJE!
Kur vriteshin fëmijët liderët e durimit bënin sefanë...
Një herë, do tjerë ftuan popullin që të dalë në rrugë: "Sot do të varroset dhuna"?!, thanë. Populli u besojë dhe dolën të gjithë në rrugë, se sigurisht do të ndodhte diçka e madhe, shpëtimtare...
„Hej sot po e varrosim dhunën!!!
Si e varrosen liderët shqiptarë dhunën?
Me rroba të zeza, kravata të kuqe, ngjyrë solemne kombëtare shqiptare që ishin simbol i patriotizmit shqiptar...
Funerali u caktua se duhet të nisej nga shkolla fillore (edhe këtë gjë se ka përkrahur LDK-ja) "Hasan Prishtina", në pjesën Jugore të Prishtinës... Edhe kjo e kishte simboliken.
Hasan Prishtina ishte emër i nderuar i kombit, i cili gjithë jetën e tij luftoi për Shqiperinë dhe pas formimit të saj për Bashkimin e Kosovës me Shqiperinë.
Kufomën nuk e morën edhe pse atë ditë, kishte vdekur një qytetar i Prishtinës, nga torturat serbe: Ibish Selmani, 22 vjeçar...
Liderët e morën arkivolin të hapur mirë .. E morën dhe e mbushën me lule..
Zahir Pajaziti iu përgjigj thirrjes gjithë popullore, për varrosjen e dhunës.
I mori dy shokë me veti, që të shohin namin që do ta bëjnë organizatorët, liderët e partive politike...
Zahiri, me një revole, 20 copë fishekë, dy bomba me vete dhe ca shokë erdhi në Prishtinë, ku iu bashkangjitë edhe Ilir Konushevci, e të cilët nga pozita anësore e rrugës, shkuan deri te varrezat e Prishitnës. Pas kryerjes së ceremonialit njerzit kokë - ulur po ktheheshin.. Zahiri me shokë kur erdhi afër hekurudhës i pa 5 - 6 policë që ishin vendosur aty.
- "Kemi mundesi t'i tymosim këta police?!"
- "JO, ka shumë popull në rrugë," iu përgjigjen shokët. "Nuk bënë"... ka shumë njerëz nëpër rrugë dhe do të pësonim...

Vazhduan rrugën dhe erdhen në një çajtore. Aty filluan të bisedojnë,... Zahiri i dëgjonte dhe si gjithmonë fliste pak. Por, kësaj here foli:
- "A e dini çka ka mbet keq në këtë ceremoni? Ti shoku im e ke profesion e pse nuk ia thirre tallkinin ?“
Shoku i tij u skuq, por iu përgjigj: “kishte dhe më të mëdhenjë se unë". "Kurse ti" iu drejtua shokut tjetër: "çka do t'i thuash LEVIZJES pse nuk e shkrepe, nuk të ka Lejuar Qendra?" Por, nuk mori përgjigje.
Iliri ndërhyri:
"Këta bëjnë politikë ilegale dhe nuk i kanë kurdisë qëndrimet?"
Të nesermen dëgjuam, se në Fushë Kosovë ishte vra një polic. Policin e varrosen me arkivol me lule. Kjo ndodhi ngase disa të rinjë vepronin pa liderë, pa qendra, por e kryenin detyrën e përcaktimit politik - kombëtar për çlirimin e Kosovës. Shokët e Zahirit ishin të bindur se këtë punë e kishte kryer ai, por fakte nuk kishin. Por, e dinin se Zahiri ditën e natën, natën e ditën kryente punë të tilla..
Përcaktimi politik i Zahirit ishte orientuar për formimin e organizatës çlirimtare me sistem dhe disiplinë ushtarake.....
Horizonti i njohurisë nga Historia Kombëtare, gjuha dhe letersia ishte shumë e gjerë. Aty kishte mundësi si Zahiri ashtu edhe të tjerët që të lexojnë libra jo vetëm ato që i kërkonin profesorët, por edhe libra të tjerë, e jo rrallë edhe libra e revista, që ishin të ndaluara nga organet e pushtetit. Librat në Besianë vinin nga Shqipëria, të cilat i sillnin punëtorët që punonin në botën e jashtme dhe forma të tjera. Librat më të kërkuar ishin: Lahuta e Malësisë, Tradhtia, Historia e Partisë së Punës të Shqiperisë, Fjalimet e Enver Hoxhës, „ Titistët“ dhe të tjera...
Nxënësit e Besianës ushqenin ndjenjen patriotike ndaj shtetit shqiptarë - Shqiperisë dhe prijesit të saj Enver Hoxhës.
Shkruarja e parullave bëhej kryesisht natën në vende publike duke filluar nga bankat dhe muret e shkollës, rrugëve të Besianës, por edhe të fshatrave të tjera...
Zahiri kishte biseduar me shokët e tij Raif Sfishtën dhe një tjetër me mbiemër Dabinovci, që të kalonin ilegalisht në Shqipëri. Familjarëve u thanë: se do të shkonin në Ulqin që të punonin gjatë muajve të verës.
Për Ulqin u nisën në korrik të vitit 1980. Aty e analizuan terrenin dhe vendosën që më lehtë mund ta kalonin kufirin duke kaluar lumin Buna me not. Më 4 korrik 1980 vendosën të kalonin në Shqipëri. Shkuan në veri të Bunës rreth 7 km dhe gjetën vendin ku më lehtë notohej. Ushtarët ishin duke festuar 7 korrikun.

Kjo ishte rrethanë lehtesuese për të kaluar Bunën më me lehtësi...
Sa dolën në Shqiperi i panë disa fshatarë duke punuar në ara. Ata lajmëruan - njëri - tjetrin dhe u larguan me shpejtësi duke bërtitur: Fshatarët dukeshin të frikësuar ngaqë mendonin që mos ishin diversantë që vinin nga Jugosllavia ngaqë gjëra të tilla kishin përjetuar më herët,,,
Ata, lajmëruan Ushtrinë shqiptare të cilët erdhën i morën dhe i dërguan në Shkodër. Aty qëndruan 18 ditë. Pas këtyre ditëve u komunikuan se do t'i kthenin ngaqë ishin të rinjë dhe se pa dijeni të familjareve e kishin bërë këtë gjë. Në Han të Hotit, ua dorëzuan policisë malazeze. Policia malazeze ua mori deklaratat dhe i detyruan të ktheheshin në Besianë.
Më 1 gusht 1980 policia e arreston Zahir Pajazitin, Raifin dhe si të mitur që ishin i denon me 15 ditë burgë (ishte para demonstratave të vitit 1981) kurse Nexhmiun me 30 ditë....
Në kohën e demonstratave të vitit 1981 Zahiri ishte në klasën e katër të Gjimnazit. Por ato ditë vlonte anembanë kosovës dhe si në ajër sikur ndjehej një lavë Vullkani që priste për të shpërthye. Në Prishtinë, ishin formuar Këshilla në ilegalitet të thellë për përgaditjen e demonstratave.. Për t'u bërë kjo gjë nevojiteshin shumë konsultime nëpër rrethe…
Në Besianë Këshilla për përgaditjen e demonstratve formuan dy grupe politike. Grupit të parë i printe Zahir Fejza, Nazmi Dumnica dhe pesë të tjerë, ndersa grupit të dytë i printe Fehmi Idriz Berisha, Salih Salihu, Hamdi Mustafa, Ejup Shala, Avdi Latifi dhe Gjyle Krasniqi, e njohur si Shota e Llapit.
Përveq këtyre grupeve, u organizua edhe LPRK-ja ku vepruan Bajram Ajeti, Ismet Begolli, Ali Ajeti, Bajrush Behrami, Avdi Gjata, Hamit Hamitit, Sabri Hamiti (s'është fjala për ak. Sabri Hamitin) Hasan Ramadani, Bedri Ajeti, Shaban Mulolli dhe të tjrë...
Njëherit vepronte edhe Fronti Nacional çlirimtar në krye Afrim Zhitinë, Esat Brajshorin, Ramadan Avdiun, Shemsi Veselin, Rrahman Dinin, Bedri Bajramin, Fatmir Brajshorin, Emin Sahitin, Hamit Beqirin, Nehat Fetoshin dhe disa të tjerë.. Pra një grup prej nja 20 vetash...Kishte dhe grupe tjera..
Duhet veçuar Grupin e Zahir Pajazitit, i cili ishte i përbërë nga 9 veta, të cilët organizonin sulme aty ku duhej thyer barikadat dhe kordonet e policisë...

Zahir Pajaziti në vitin 1981, ishte nxënës në Qendrën Arsimore " 8 Nëntori" në Besianë. Ishte sistemuar në paralelën IV/16 e kujdestar klase e kishte pasur Izeir Mustafën, skulptor akademik.
Izeirit i kujtohet, se edhe para vitit 1981, Zahiri e mbante një fletore me poezi patriotike dhe shpesh m'i lexonte ose i recitonte. Unë e këshilloja:" Ruaju Zahir, se për këto shkon disa vjet në burg,"
E, ai përgjigjej: "E di unë kujt ia lexoj! Por, mos harroni se kush më spiunon, jeta e tij përfundon"...
Organizimi i demonstratave në Besianë me ato përmasa nuk ishte i rastit.
Më 2 prill të vitit 1981 intervenoi policia dhe u plagos Hetem Ajeti.. Në mbrëmje u formua Këshilli për Organizimin e Demonstratës dhe u emerua si udhëheqës Ali Ajeti dhe Gjyle Krasniqi...
Në fshatin Besi, aty te shkolla e mesme me emrin „Nexhmi Mustafa“ që ishte paralele e ndarë e Gjimnazit të Prishtinës nxënësit e kësaj shkolle s'bashku me fshatarët sulmojn një autokolon të Policis serbe dhe pasi që arrijn të marrin një kamion, vërejn që aty kishte Pushkëautomatike dhe sanduqe me plot municione. Armatimin e marrin dhe kamionit ia dhënë flakën!

**ZAHIRI NË USHTRINË JUGOSLLAVE**

Zahir Pajazitin pas demonstrative të vitit 1981, e morën ushtarë.. Brenga e dytë e Zahirit gjatë shërbimit ushtarak në Ohër ishte edhe sjellja e eprorëve ushtarakë ndaj shqiptarëve. Aty oficerët në ligjerata politike, villnin helm e vrerë ndaj shqiptarëve si nacionalistë dhe irredentistë, si armiq e kunderrevolucionar, si element që luftonin kundër vëllazërim - bashkimit, për rrënimin e sistemit socialist, për rrënimin e Jugosllavisë.
"Pse po rrejnë këta oficira? Ne nuk jemi të tillë!"
Pse po rrenë shtypi? Pse po na quajnë si të tillë? Dëgjoheshin herë-herë këto pyetje kudo nga shqiptarët jo mirëtë informuar.
Zahiri mendonte sikur shumica e ilegalëve të organizuar :
"Ashtu është. Ata po e thonë të vërtetën. Ne ashtu mendojmë për Jugosllavinë. Ashtu edhe duhet të jemi dhe të veprojmë".
„Ne jemi armiqë të Jugosllavis!“
Celulat e para politike dhe ushtarake, që u formuan edhe pas Luftës së Dytë Botërore, kishin për qëllim çlirimin e Kosovës. Një ndër të parat ishte Komiteti Nacional Demokratik i Shqiptarëve më në krye Halim Spahia i Prizrenit.

Komiteti Qendror vendosi që edhe në Llap të formohet RRethi i NDSH-ës së Besianës dhe kryetar u zgjodhë Ramë Muharremi (i njohur si Mulla Ramë Govori /Hertica/)..
(Rama ka jetuar gjerë në vitet e tetëdhjeta dhe gjatë tërë kohës ka qenë i maltretuar nga pushtetet e ndryshme të ish Jugosllavis; qofshin ato pushtete serbe apo edhe të udhëhequra nga shqiptartë,,, Ka jetuar në „ Vranjevc“ ose siç njihet sot si „Kodra e Trimave“ një lagje të cilën Beogradi e kishte cilësuar si: „Bastion i Nacionalizmit!“
Në këtë rajon të Besianës, ndihmë të veçantë dhanë edhe Rrustem Statovci, Selim Shabani,Qerim Sharbani, Ramadan Berisha, Ramadan Ajvazi, Ajet Gërguri ndërsa prijës ushtarak i rajonit më 1946 - 1948 ishte Musli Dumoshi... Pas burgosjeve dhe vrasjeve të ndryshme serish në vitin 1949 u aktivizua NDSH-ja me Sabit Kapitin...
Sabiti ishte një atdhetar i devotshëm i çështjes sonë Kombëtare dhe frymëzuesi kryesor i bacës Adem Demaçit!
Pas burgosjes së anëtarëve të NDSH-ës aktivitetin e vazhdoi kjo organizat që nga 1953 me Shaban Shalën...
Që nga viti 1949 deri në vitin 1964 u burgosën disa grupe politike. Ndër intelektualët e burgosur më 1958 ishte dhe Adem Demaçi, i cili pas daljes nga burgu formoi Lëvizjen Revolucionare e Bashkimit të Shqiptarëve, për të cilën besoi që veq dini mjaftë dhe s' do shkruaj më shumë...
Për burgosjet e Ilegalëve të vitit 1964 dhe organizatorëve të Demonstratës së vitit 1968, nuk do të shkruaj ngaqë ajo është temë në vete por në romanin tim „Udha e Blirëve“ e kam pasqyruar më së miri këtë aktivitet të Osman Dumoshit, Xheladin Rekaliut, Vëllezërve Pireva etj etj.
Grupi Ilegal me emrin " Liria" u formua në vitin 1978. Këtë grup e formuan Bajrush Behrami, Kadri Llugaliu, Xhafer Spahiu dhe të tjerë, si nga Besiana ashtu edhe nga Ferizaj. Grupi ilegal " Liria", mori pjesë aktive në organizimin e demonstratave të vitit 1981. Aso kohe Ismet Begolli kishte hartua një trakt të cilin e kishte shumëzuar Bajrush Behrami, e pastaj u shpërnda në tërë rajonin e Llapit, por edhe në Prishtinë...Pas formimit të LPRK-ës grupi ra në kontakt me ta...
Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare është parti ilegale e formuar në vitin 1972, në Frankfurt të Gjermanisë. Themelues partie ishin Emin Fazliu alias Emil Kastrioti, Vehbi Ibrahimi, Rasim Zeneli

dhe Hisen Çami. Partia u mundua të bashkëveprojë edhe me Jusuf Gërvallën por nuk arritën marrëveshje.. Kjo ndodhi më 1980.
LËVIZJA NACIONALÇLIRIMTARE e Kosovës dhe e viseve te tjera në Jugosllavi për Bashkim me Shqiprinë vepronte ilegalisht në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, por edhe jashtë vendit.
FILLIMISHT KRYETAR I LËVIZJES ISHTE BACË METUSH KRASNIQI. Me këtë Lëvizje bashkëpunoi edhe Jusuf Gërvalla, i cili kur shkoi në Gjermani u bë ndër aktivistët më të njohur të kësaj Lëvizjeje. Në këtë Lëvizje ishte edhe Ahmet Haxhiu, i cili kishte ndikim politik, të madh, në rajonin e Llapit e të Prishtinës. Xhavit Hoxha i Junikut( vëllai i Edmond Hoxhës) ishte anëtar i kësaj Lëvizjeje së bashku me Jashar Salihun dhe anëtar të Komitetit të Deçanit. Xhaviti ishte njohur me Beqir Hajrizin e Bardhashit të BESIANËS.
MË 10 MARS TË VITIT 1981 NË SHTËPINË E AVDYL MUSTAFËS NË VENDENIS U TAKUAN FEHMI BERISHA, HETEM AJETI, HAMDI MUSTAFA DHE AVDYL MUSTAFA. MË VONË NË KËTO BISEDA DHE AKTIVITETE ISHIN BASHKANGJITUR EDHE AHMET HAXHIU, AVDI LATIFI, NAZMI SEJDIU DHE GJYLE KRASNIQI...
Fehmi Berisha mori iniciativën për organizimin e demonstratave në prill të vitit 1981. Bashkë me Sali Salihun ishte në Lidhje me GANI KOCIN - anëtar i grupit organizativ të studentëve në Prishtinë. Më 31 mars të vitit 1981 Fehmi Berisha burgoset...Burgosja e tij ishte një humbje për radhet e organizuara aqë më parë ngaqë ilegalja kishte të bënte me një ilegal që ishte në formim e sipër,,,
Mbledhje të tilla ishin mbajtur edhe në shtëpin e Avdi Latifit (Monollit), por edhe të Fehmi Berishës...
Në vitin 1981 u formua edhe grupi i punëtorëve me Zahir Hazir Fejzën dhe gjashtë anëtarë të tjerë... Grupi u zbulua dhe Zahiri( Fejza) dhe Nazmi Dumnica u dënuan me nga 7 vjet burgë...
Fronti Nacionalçlirimtar u formua edhe në rajonin e Llapit. Në mesin e tyre ishte edhe Afrim Zhitia, një nga persdonalitetet më të njohura politike, jo vetëm në rajonin e Besianës, por edhe në Prishtinë, dhe në tërë Kosovën.

Në rajonin e Llapit veproi dhe Organizata Marksiste Leniniste e Kosovës ose shkurt OMLK-ja. Ndikim në këtë rajon pati edhe Fronti i Kuq Popullor..

**KOSOVA E RE**

Organizata" Kosova e Re" u formua në vitin 1981. Kryetar ishte Naser Grajçevci, ndërsa anëtarë: Fatmir Humolli, Akile Dedinca, Hyzri Talla, Sali Konjusha, Zijadin Bajçinca dhe të tjerë. Ata botuan Organin e tyre " Përpjekja"...

Organizata mbante lidhje edhe me grupet e tjera ilegale, sidomos me grupin e Sejdi Veselit dhe me Grupin e Kadri Osmanit. Kur u zbuluan këto dy grupe u zulua edhe Organizata "Kosova e re". Fillimisht u burgos Naser Grajçevci pastaj Fatmir Humolli, Akile Dedinca, Sali Konjusha dhe Zijadin Bajçinca...Por, fatmir Humolli nuk e zbuloi grupin ilegal që ishte në lidhje me të si Hyzri Talla, Blerim Pireva, Bedri Humolli, Safet Humolli dhe të tjerë... Me këtë u krijuan mundesit e vazhdimit të punës ilegale të grupit " Kosova e Re"...

Po ashtu për Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës, më vonë ( pas dy korrikut të vitit 1990) Lëvizja Popullore e Republikës së Kosovës ndersa që nga korriku i vitit 1993 Lëvizja Popullore e Kosovës, dihet pothuajse çdo gjë dhe nuk do të elaborojë ndonjë gjë me këtë rast...Por dua të them vetëm këtë gjë:

Shtylla e saj kryesore për Llap dhe Prishtinë ishte padyshim Ahmet Haxhiu - Plaku i cili kishte krijuar bazat e tija në shtëpit e Maliq Brajshorit në Prishtinë, pastaj në Dyz te shtepia e Nazmi Llapashticës dhe një tjetër në shtëpinë e Sabri Ukës. Po ashtu bazë të fortë kishte krijuar edhe në shtëpin e Sahit Krasniqit në Kastriot... Por baza më e njohur për strehimin ilegal dhe të teknikës ishte shtëpia e Ahmet Haxhiut në Prishtinë.

Nga ajo shtëpi e Ahmet Haxhiut dhe nga shtëpia e Maliq Brajshorit janë shtypur afishe dhe trakte e më vonë " Rruga e Lirisë" dhe " Minatori", nën përkujdesjen e Afrim Zhitisë e Fatmir Brajshorit (Numri katër dhe pesë), Hajdin Abazit dhe Fadil Vatës...

Në Llap ekzistonin edhe grupe tjera politike ilegale dhe ato kishin formuar bazat e tyre. Pas burgosjeve të shumta të vitit 1982 si Shefqet Cakiqi, Afrim Fusha, Muhamet Imeri, Bedri Ajeti dhe Ismet Cakiqi pastaj gjatë vitit 1983/ 84 Mustafë Xhemajli, Sherif Konjufca, Bajrush Behrami pastaj Fadil Lepaja, Ismet Begolli, Ali Ajeti (kerkoj falje nëse nuk i përmendi të gjithë emrat ngaqë janë të shumtë dhe kujtesa

e sotshme mundet t'më sjell në lajthitje), Nazmi Llapashtica, Hetem Ajeti....

**ORIENTIMI PËR LUFTË TË ARMATOSUR**

PAKENAQESIA E SHQIPTARËVE( viti 1989) në Kosovë sa vinte e shtohej në të gjitha shtresat e popullsisë.. Më 28 mars 1989, Kuvendi i Serbisë miratoi ndryshimet në Kushtetutë, me të cilën suprimoi Autonomin e Kosovës.

Më 29 mars 1989 u shkrua komunikata nga Fadil Vata, Ahmet Haxhiu dhe Shaban Muja, e cila u shpërnda në Kosovë, e më 17 prill 1989 edhe në shtetet e Evropës...Në Podujevë u shperndanë nga Grupi i Ali Ajetit ndersa në Prishtinë shperndarja ishte bërë nga disa grupe e që Kordinoheshin nga një Rreth i LPRK-ës.

Në këtë kohë Grupi i Zahir Pajazitit shtrihej në Gallab, në Llap, por edhe në Prishtinë, prej nga ishin anëtarët e grupit të tij. Grupi kishte shtrirje të gjerë por nuk u dekonspirua... Për aksione dinin vetëm pjesmarrsit e drejtpërdrejtë Afrim Zhitia, Fatmir Brajshori, Fahri Fazliu edhe Ramadan Avdiu që kishte dalë nga burgu dhe ishte ndihmë e madhe për ilegalen...

Grupi i Prishtinës mori një aksion ato ditë, ku vuri eksplozivin te gjeneratori RTP (Radio Televizioni i Prishtinës) por që fatkeqësisht dinamiti i vendosur nuk kiushte ndezur,,,

Për kordinimin e aksioneve, Zahir Pajaziti kontaktonte me Afrim Zhitinë. Pas vrasjes së Afrimit ai mbajti lidhje me Nazmi Zukën dhe përmes tij me Fatmir Humollin (që kishte hapur një furrë-bukëpjekës, në Kodër të Trimave njëherit edhe si bazë) dhe Hajredin Hysenin.

Zahiri me grupet e Drenices mbante lidhje, por edhe me ato të Dukagjinit dhe të Ferizajt.

**ÇETA E LLAPIT**

Grupi politike ilegal i të rinjëve u formua në maj të vitit 1981. Aty ishin Naser dhe Blerim Hyseni të cilet ishin denuar me 15 ditë burg ndersa sabri Kiçmari dhe Avdi Visoka me të holla. Këta u perjashtuan nga shkolla fillore në Besian, të cilet u rexhistruan ne shkollen fillore në Laberion nga i larguan serish për të vazhduar pastaj në Llapashticë.

Policia më 27 shtator 1988, kishte arrestuar anetaret e grupit ilegal Fidaim gashin, Hysen jasharin, Nezir Haziri, Bajram Haziri, Naser Beka, Skënder Murati, Hajredin Hyseni, Nexhat Maliqi, Fikrie Musa dhe Ruzhdi Kiçmari... Një pjesë e grupit e mbetur kaloi në ilegalitet si

Sabri Kiçmari, Naser Hyseni, Fahri Ajeti, Naime Jashari, Enver Behrami, Fexhrie Potera... Naser Hyseni ishte në lidhje me Bedri Blakqorin dhe Gani Hoxhën. Grupi kaloi në ilegalitet si në Besianë po ashtu në Prishtinë dhe në Drenicë... Qendra kishte vendosur që grupi ilegal të emigrojë në Botën e Jashtme. Ata kishin pergaditur edhe pasaporta dhe dy vetura. Nga Besiana dhe Kastrioti shkuan në Lublanë dhe kufirin me Italinë e kaluan në këmbë maleve. Në Zvicer kaluan Naser Hyseni, Fahri Ajeti, Enver behrami, Fexhrie Potera dhe Naime Jashari. Qendra kishte vendosur që Sabri Kiçmari ta vazhdojë punën ilegale në Kosovë. Atij iu bashkuan edhe Hasan Ramadani dhe Shaban Mulolli.

LPRK-ja kishte vendosur që gjatë muajit mars të organizoheshin demonstrata ku të kishte mundësi (1989).

Në Besianë demonstrata u organizua më 27 mars të vitit 1989. Demonstrusit së pari u tubuan afër Shtëpisë së Kulturës. Para tyre doli një grup policësh i prirë nga Jetullah Kuqi, komandant i policisë në Besianë, i cili në një dorë mbante shufrën e gomës e tjetren e kishte ngritur që të komunikonte me masën.. Disa demonstrues, e kanë tërhequr dhe e kanë futur në mesin e tyre. Policët e tjerë u munduan ta terheqin dhe e nxorrën nga turma. Aty afër ishte edhe Isa Ejupi( fshati Sopatë). Në atë moment, dikush shtiu në Jetullah Kuqin dhe mbeti i vdekur në vend. Aty u plagos edhe polici serb Zoran Koraç, të cilin e quanin Kvaq.

Vrasjen e bëri një person me rroba të zeza dhe këmishë të bardhë. Masa nuk e ka njohur. Edhe sot e kësaj dite kjo vrasje ka mbetur enigmë.. Edhe dy djem të axhalarëve të Jetullah Kuqit që punonin në SPB i kishin larguar nga puna... Babai i Jetullahit kishte deklaruar: " Djalin m'a vranë UDB-a"... Aty ishte vrarë nga radhet edemonstruesve Mehmet Ejupi i lindur në vitin 1965, më 11 tetor në fshatin Sekiraçë (Sopatë) të Vendenisit (Gllamnikut)...

Grupi Gueril i Llapit më 27 MARS ISHTE I ORGANIZUAR DHE I ARMATOSUR. NJË NGA BAZAT ISHTE SHTEPIA E MUSTAFË AJETIT. ATY U VENDOSËN: ALI JETI, ISMET ABDULLAHU, BASRIJE MURATI - SHQIPJA, GANI HOXHA DHE GANIMETE ABDULLAHU. Në këtë kohë guerilja i kishte bazat e veta në Livadhi, në shtëpinë e familjes së Halim Abdullahut, në shtepi të Hasan Ramadanit në Albanik, në shtepinë e Ramadan Fazliut në Besianë, në shtepinë e Vehbi Rushitit dhe Hasan Rushitit, në shtëpinë e Xhafer

Spahiut – Vendenis; një bazë ishte në Dardhishtë, në Dyz dhe në Herticë, në shtepinë e Muhamet Latifit në Pollatë, në shtepinë e Qazim Tovërlanit dhe Tahir Rrahmanit në Livadhi, në shtëpin e Shaban Ajetit në Mirash, në shtepinë e Beqir Hajrizit në Bardhosh.. Beqiri ishte edhe në grupin e Mehë Ukës dhe ishte nga Bajgora..
Në këto baza kanë qëndruar edhe ilegalet nga viset e tjera si HAJDIN ABAZI - LUM HAXHIU, ALI AHMETI, BARDHYL MAHMUTI. POR EDHE SHUMË TË TJERË. EDHE AFRIM ZHITIA ËSHTË STREHUAR NËPËR KËTO BAZA E SIDOMOS NË PRISHTINË NË SHTëPIN E FATMIR BRAJSHORIT ku ishte vendosur baza; teknika dhe një pjesë e armatimit...
Lum Haxhiu në kohën e qëndrimit në Llap, e kishte nofkën Rexha. Ai ishte i armatosur me një "uzi" dhe një revole.
Me përvojën e tij e ndihmoi lëvizjen ilegale edhe në këto anë...
Grupi ilegal në vitin 1989 ishte i madh. Kërkesat për tu futur në guerile ishin shumë të mëdha. Guerila e LLapit dhe Gallabit u organizua nëaspektin ushtarak, komandant i së cilës u zgjodhë Ali Ajeti dhe neper baza ishin caktuar përgjegjësit. Përveq kësaj e kishin udhëheqsin politik Sabri Kiçmarin. Hierarkia respektohej me perpikmeri. Askush nuk guxonte të ndërrmerrte aksione pa pëlqimin e Ali Ajetit. Për shkak të përgjegjësive të mëdha kryesisht në bazë qëndronin Ali Ajeti dhe Sabri Kiçmari....
Për shkak organizimit ushtarak grupi i guerilës së Llapit u bë i njohur me emrin Çeta e Llapit!!!!
Çeta e Llapit vendosi të bëjë organizimin e një demonstrate më 30 maj të vitit 1989. Ishin marrë dhe vendimet. Ahmet Haxhiu u njohtua të njeten ditë për vendimet. Kjo çështje u shqyrtua të njetën ditë nga Këshilli i Përgjithshëm i LPRK-ës: Ahmet Haxhiu, Fadil Vata, Hidajete Krasniqi dhe Avdyl Mustafa. Ata vendosen që Çeta e Llapit të pengohej që të mos dal e armatosur në demonstrata. Për këtë ngarkuan Fadil Vatën i cili mnegjithë përpjekjet nuk mundi t'i gjejë për të kontaktuar me ta…
Pankartat dhe parullat i kishte pergaditur Sabri Kiçmari - Zefi me shokë në shtepin e Ali Ajetit por pa Ali Ajetin, i cili kishte shkuar nëper baza, me i pergadit shokët ndersa gjatë asaj nate, roje kishte bërë edhe nëna e Alisë Vahidja... Të nesërmen kishte shkuar edhe Aliu. Kur u nisën për në demonstratë i porositi: " Ruani, bijë , se katilat u dalin përpara.

E Aliu iu përgjigj: Nënë, jemi marrë vesh për këtë punë".
Demonstruesit arritën deri në qendër të Besianës. Policia ndërhyri me shkopinjë gome. Pati të shtëna edhe nga ushtarët e Çetës së LLapit, por vetëm në mbrojtje... Por në nderkohë kishte arritur njesia speciale e policisë jugosllave.. Ata me mjete të blinduara dhe me helikopterë, sulmuan dhe shpërndanë demonstruesit. Një pjesë e Çetës së Llapit ku ishin Ali Ajeti - komandanti dhe Sabri Kiçmari, udhëheqësi politik, u tërhoqen në drejtim të Gjimnazit, në drejtim të fshatit Merçez, dhe u orientuan për në bazën e tyre. Bashkë me ta ishin edhe nja 50 demonstrues ndersa në mesin e tyre kishte edhe vajza.. Helikopteri filloi të shtinte me armë zjarri dhe me gazra helmuese. Nga toka policia i ndiqte dhe i percillte hap pas hapi... Kur policia ishte afruar Ali Ajeti e ktheu automatikun dhe kishte filluar të shtinte. Policia nuk e kishte pritur një guxim të tillë.Për momentin u shtrinë për tokë dhe kërkuan ndihmë nga helikopteri, i cili u erdhi në ndihmë. Ali Ajeti luftoi me trimëri. Në atë rast ai u plagos. Shokët u përpoqen ta terhjekin. Sabri Kiçmari e kishte bartë mbi supet e tija,,, Ai urdheroi ta linin dhe i plagosur mbrojti tërheqjen e tyre. Policia hetoi se më nuk mund të shtinte dhe filluan të afroheshin. Ende ishte i gjallë. Policët nga afersia shtinë dhe kështu mbeti i vrarë Ali Ajeti, komandant i Çetës. Anetaret e tjerë, u terhoqën në bazë. Safet Ajeti e mbante flamurin, i cili ishte i shpuar nga plumbat... Secili grup ishte terhequr në bazë të caktuar...
Pas kesaj ngjerjeje mundesia e qendrimit të Çetës së Llapit ishte e vogël kështu që u miratua vendimi që më të rrezikuarit të largoheshin nga Kosova. Për shkuarjen e tyre për në shtetet perendimore u organizuan: Ahmet Haxhiu, Fadil Vata, Shaban Muja, Avdi Latifi, Sabri Uka, Nazmi Llapashtica, Avdyl Mustafa, Sabri Kiçmari, kurse nga dega jashtë vendit: Ali Ahmeti,dhe Emrush Xhemajli.. Një pjesë të pasaportave e ka pergaditur Sahit Krasniqi nga Kastrioti. Të parët u larguan nga vendi Bajram Ajeti dhe Basrije Murati - Shqipja.
Shumica PREJ TYRE U LARGUAN POR DISA NUK PRANUAN SI RASTI ME HASAN RAMADANIN E ALBANIKUT. Nga ana tjetër, me Çetën e Llapit ishte në lidhje edhe Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu pastaj edhe disa të rinjë, në mesin e të cilëve ishte edhe Rrustem Mustafa - Remi, i cili kishte qenë në bazën e Çetës në Ballsh dhe në shtepinë e Hasan Ramadanit..

Me rastin e burgosjeve të shumta nuk u dekonspiruan: Beqir Hajrizi, Sheqir Hasani, Nuhi Ajeti, Hetem Ajeti, Fadil Lepaja, Pajazit Jashari, Rukije Ajvazi dhe të tjerë...
Zahir Pajaziti në atë kohë nuk ishte anëtar i LPRK-ës por bashkëpunonte me pjesen më të madhe të tyre siç ishin: Ali Ajeti, Gani Hoxha, Shaban Mulolli, Hasan Ramadani, Afrim Zhitia. Në bazën e Çetës së Llapit, në shtepinë e Enver Osmanit, u takua me luftëtarët dhe me Ismet Abdullahun u percaktuan format e bashkëpunimit..
Kur u formua Ushtria Çlirimtare e Kosovës (Në Prishtinë më 26 dhe 27 korrik të vitit 1993) këto grupe ishin bashkëformuese. Lidhjet me jashtë i mbanin me Ismet Abdullahun (Zahiri) dhe pas njohjes që u bëri Ismeti edhe me Ali Ahmetin. Zahiri vlersonte lartë përgatitjet ushtarake që i bënin Hajredin Hyseni dhe Fatmir Humolli. Lidhjet i ka mbajtur nëpërmes Nazmi Zukës, i cili ishte udhëheqës ushtarak për rajonin e Llapit dhe të Gallabit...
Zahir Pajziti, që nga viti 1981, ishte percaktuar për luftë çlirimtare. Format e angazhimit të tij ishin ato të kohës si; demonstrata, protesta, greva, shpërndarja e afisheve dhe e trakteve, aksioneve të ndryshme e nder to edhe aksione subversive, rrehtimi në njësitë guerile dhe formimi i tyre, sigurimi i bazave për strehiminn e ilegalëve nëpër fshatra dhe qytete, sigurimi i armëve dhe i municionit...Njëherit rënde¨si e veçantë e ilegales dhe njesiteve guerile para formimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte edhe bashkëpunimi me Shqiperinë jo vetëm për të mësuar e stêrvitur guerilën shqiptare, por edhe për vendosjen e të dekonspiruarve…
LPRK-ja i kishte vë vetes për detyrë të formojë krahun e vet ushtarak dhe për këtë Komiteti Drejtues kishte dhënë direktivë të qartë për formimin e Këshillave të Rrethit të LPRK-ës...
Kështu ishte formuar Këshilli i Rrethit për Pejë që udhëhiqej nga Adem Grabovci, Ibish Neziri, Havë Shala, Lulëzim Etemaj pastaj për Burim Me Xhevat Zekën, Këshilli i Rrethit për Prizren që udhëhiqej nga Behajdin Hallaqi (bënte pjesë edhe Nait Hasani)…
Ndërsa në veçanti ishte Këshilli i Rrethit për Prishtinë, ku bënin pjesë:A frim Zhitia, Fahri Faliu, Fatmir Brajshori, Ramadan Avdiu dhe Avni Klinaku me udhëheqesin dhe ideatorin Fadil Vata; pastaj në Klinë Këshilli i Rrethit me Sahit Berishën, Për Mitrovicë me Raif Qelën më vonë Kadri veselin, Për Drenicë më Azem Sylën. Mehmet

Bislimin, Hashim Thaqin,Këshilli i Rrethit për Preshevë me halil Selimin, Adnan Asllanin, Për Strugë me Guximtar Ladorishtin, Për Kërçovë me Beqir Limanin, në Llap Ali Ajeti, Gani Hoxha, Shaban Mololli, Hasan Ramadani, Bedri Blakqori por edhe Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu sipas nevojës...

...

**ZAHIRI DEL NË SKENË**

Zahir Pajaziti më 27 dhe 28 qershor kishte pergaditur grupin e tij, me rastin e ardhjes së serbëve përtëkemtuar humbjen e tyre më 1389, që të mbrojë popullin nëse sulmohej nga hordhitë serbe... Çeta e Llapit mori udhëzime nga Qendra që të kalonin në ilegalitet dhe ua ndaloi që të organizonin vrasje të policisë serbe me qëllim që të kursehen ata dhe populli...

Në nëntor të vitit 1989 , lidhur me vrasjen e Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, Zahir Pajaziti kishte vlersuar: " Populli i Kosovës pati humbje të madhe...

Zahiri kishte organizuar STËRVITJE USHTARAKE EDHE NË KOSOVË DHE ATË NË FSHATIN GURASH TË LLAPIT, ku, NË NJË ORË MËSIMI U KISHTE THËNË:

"Burra, rruga prej nga jemi nisur e deri të arrijmë në krye të saj ¨shtë e rëndë, e vështirë, e pse jo edhe e rrezikshme. Qëllimi ynë është çlirimi i popullit shqiptarë dhe bashkimi i tij në një shtet - Shqipëri... Duhet të shkojmë në luftë jo për të VDEKUR se nuk jemi FATALIST por për të FITUAR! Sot jemi grup politiko - ushtarak por nsër do të jemi Ushtri Çlirimtare!

"Pushka juaj qoftë e nderuar dhe ju priftë fati në luftën e ardhshme çlirimtare".

Djemët e ilegalës ishin djem nanash dhe sy patrembur. Ata ishin mëtë bukurit e të bukurve ngaqë në vete e kishin të ngershyer Atdhe - dashurin, përjetesin kështu që; me ta toka bëhj me diell kur kishte nevojë për të e me shi kur e donte bereqetin...

Edhe vajzat filluan të krenoheshin me trimerinë e djemëve të ilegalës.

Nga të dhënat shohim se Zahir Pajaziti si veprimtar politik, por edhe si ushtarak, ishte ii afërt dhe i kujdeshëm me shokët. Virtytet e larta të tij, si nderi, guximi, trimëria, ishin veti të veçanta të tij. Zahiri në aspektin ushtarak ishte i pergatitur si në aspektin fizik po ashtu dhe psikik.Ai ka njohur dhe ushtruar të gjitha llojet e armëve e edhe për luftë kundër njësis tankiste dhe ajrore.

Zahiri gjatë stërvitjeve ushtarake u shpjegonte ushtarëve të tij: " Puna e parë është njeriu, i cili caktohet të zënë pusinë. Faktori njeri. Faktori tjetër është vendi ku zihet pusia.
KËTO ISHIN VETËM DISA NGA VETITË QË ZAHIRIN E BËNË TË NJOHUR, FILLIMISHT SI USHTAR I GUERILËS DHE PASTAJ SI KOMANDANT I GRUPEVE USHTARAKE DHE NË FUND SI KOMANDANT TË SHTABIT OPERATIV - QENDROR TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS... PËRPOS GRUPIT TË ZAHIRIT, NË LLAP VEPRONTE EDHE NJË GRUP TJETËR. ZAHIRI NË NJË RAST I TREGOI GRUPIT TË TIJ SE NË LLAP VEPRON EDHE NJË GUERIL, i cili ka kërkuar të bashkohej me ta:nuk tregoi emrin e askujt por dyshohej se mos ishte emri i Hetem Ajetit, i cili vërtet kishte bërë disa aksione të armatosura...
Elita politike shqiptare me filozofinë e tyre donin të ushqenin me iluzion se gandizmi është rruga më e mirë por te një pjesë e popullit, u rrit besimi në mundësinë e luftës dhe të fitores kundër pushtuesit. Përgaditjet politiko - ushtarake kishin filluar të bëhen edhe në Llap si në rajone tjera në Drenicë dhe në Rrafshin e Dukagjinit. Këto përgatitje ishin vepër e LPRK-ës por edhe e disa grupeve tjera ilegale por që nuk ishin në LPRK-ë..
Shqiperia ishte e interesuar që në rast se vije te lufta e mbrendshme, në Jugosllavi, shqiptarët në Kosovë të jenë në aspektin politik dhe ushtarak sa më të përgaditur...
Ramiz Alia pas konsultimeve me Byronë Politike u dakordua për mundesin e formimit unik - politik dhe uahtarak. Ramiz Alia nënshkroi dekretin për organizimin e përgatitjeve ushtarake (të mos harrojmë se akoma ishte viti 1991) në territorin e Shqiperisë... Fillimisht u caktua Serreli dhe Selishta, kurse më vonë parashihej edhe në thellësi malore në afersi të kufirit me Kosovën. Kadetët rreth 600 veta duhet të dergoheshin fillimisht duke filluar me grupe dhe atë të parin prej 50 vetave.. Të gjitha shpenzimet për kadetë i kishte siguruar shteti - Ushtria Shqiptare ( si uniforma, armët, municionin, vendosjen në kazermë, ushqimin, ruajtjen e sekretit)... Zgjedhja e kadetëve ishte obligim i vet shqiptarëve nga Kosova të cilët mirreshin me këto organizime...
Për zgjedhjen e kadetëve+nga zona e Llapit ishte caktuar Isa Berisha nga majaci. Këtë punë e bëri në marrëveshje me Ismet Abdullahun, i

cili mbante lidhjet me Enver Osmanin nga fshati balsh, aktivist i LPRK-ës...

**Zahir Pajaziti me grupin e parë që shkuan për ushtrime ushtarake në Shqipëri.**

Nga Prishtina për Ushtrime Ushtarake në Shqiperi në grupin e parë mori pjesë edhe Shaip Haziri, i cili udhëtoi bashkë me Zahir Pajazitin dhe Fadil Begun nga Prishtina Shefket BRajshorin etj, në Cyrih. Zahiri qysh heret ishte njohur me Ismet Abdullahun tek i cili qëndruan dy ditë pastaj shkuan në Triestë të Italisë, ku u bashkuan dhe me kadetët e tjerë dhe vazhduan për në Shqipëri.. Aty i priti Zymer Berisha... Në grup ishin 54 kadetë nga Kosova. Ramiz Alia kishte caktuar Adem Çopanin, i cili ishte në cilësin e këshilltarit ushtarak. ushtrimet u zhvilluan në konspiracion... Shtabi i ushtrisë Shqiptare kishte caktuar në krye kolonelin Hysen Gegaj dhe zëvendës Agron Dhimarko. Aty ishin edhe eprorët:Tahir Sinani, Kastrioti, Ronaldi, Ylli dhe Ramazani...Zahir Pajazitin koloneli Hysen Gegaj e ka caktuar komandant skuadre.. Nga ky moment kishte filluar bashkëpunimi i ngushtë i Zahirit me eprorët ushtarak në Shqiperi e sidomos me Hysen Gegajn dhe Agron Dhimarkon.

Më voë Zahiri shpesh është konsultuar me këta dy eprorë gjerë në vitin 1997...

Mirepo në Kosovë nuk ishte vetëm ky grup ushtarak që vepronte. Pyetje e domosdoshme ishte si të bëhet Bashkimi i grupeve? Vrasja e Ali jetit dhe shkuarja e disa luftetarëve të Çetës së Llapit në Perëndim si dhe vrasja e njerit prej udhëheqësve të LPRK-ës ishte humbje

madhe...
Sa ishte gjallë Afreimi e emeroi Hasan Ramadanin komandant të Çetës së Llapit.. Ditën kur i kishte dhënë edhe një automatik mu në shtepinë e Ali jetit në Besianë, që e shfrytzonte si bazë për strehim.. Në automati hasan ramadani i kishte gravuar inicialet e A. ZH. Hasan Ramadani kishte lajmëruar se në grup i kishte 10 veta... Grupet për shkak të konspiracionit një kohë do të vepronin ndamas.. Grupi i Zahir Pajazitit kishte Hakif Zejnullahun, Isak Shabani, Rrahim Haziri, Agimi vëllai i Zahirit, Fadil Pajaziti, Fadil Begu, Enver Osmani, Ajet Ahmeti dhe disa të tjerë nga Batllava dhe nga fshati Plepaj...
Mbledhja e Përgjithshme në nivel të Rrethit u mbajtë në fshatin Mirash në vitin 1991.. Në këtë mbledhje kanë marrë pjesë afro 24 delegatë ( s'më kujtohet saktësiht numri) por edhe Fatmir Humolli dhe Nazmi Zuka.. Ishte ftuar edhe grupi i intelektulëve dhe në emër të tyre letren përshendetëse e kishte derguar Abdyl Lahu, përmes një delegati... Në Mbledhje u moren vendime me rendesi si bashkimi i grupit të Fatmir Humollit dhe Nazmi Zukës me LPRK-ën ( më vonë Fatmiri serish largohet dhe formon me të tjerë LKÇK-ën).. Aty u bë zgjedhja e Kryetarit dhe e Këshillit të Rrethit në këtë përbërje: Fatmir Humolli, Hysen Jashari, Fidaim Gashi, Ruzhdi Kiçmari, Bajram Hajrizi dhe Sahadete Zhitia... Sahadetja ishte përgjegjëse për organizimin e femrave në rrethinën e Besianës...
Për formimin e Shtabit ushtarak të Besianës ishte duke punuar LPRK-ja kryetar i së cilës ishte Hajredin Hiseni. Vetën në Llap dhe Gallab ishin formuar më shumë se 70 këshilla. Në kuadër të Këshillit"të Përgjithshmëm behej organizimi politik, ku ishte formuar Shtabi Ushtarak i Besianës. Ky ishte vendimi më i rëndësihëm i LPRK-ës. Në bazë të këtij vendimi u formua ( keshtu u em¨rua në faktë) Nj¨siti Gueril i Llapit e më vonë skuadra Ushtarake e llapit, komandant i së cilës ishte Hyswen Jashari. Në mesin e luftëtarëve të skuadres ishin: Nazmi Ajeti, Fatmir Sfishta, Halim Rrmoku, Bajram hajrizi, Rrustem Mustafa - Remi dhe të tjerë...
Shtabi ushtarak veproi në këtë përbërje: Nazmi Zuka, shef i Shtabit, kurse anëtarë të tjerë ishin Naser beka, Faik Ajeti dhe Ismet Mahmuti...Udhëheqja politike me Dinin ishte në hall të madh ngaqë Qendra e ( LPRK-ës) nuk lejonte aksione të armatosura por vetëm përgatitje ushtarake për luftë kurse skuadra ushtarake kërkonte aksione të armatosura...Shpesh herë pjestaret e kësaj skuadre kishin

bërë ca veprime, aksione të cilat Qendra s'i kishte pritur edhe aq mirë...
Nazmi Zuka në vitin 1990 arriti të formojë gripion politiko - ushtarak në këtë përbërje: Zahir Pajaziti, Kadri Pajaziti, Rrahim Haziri, Isak Shabani, Sahit Deliu, Ismet Haliti, Muhamet Nura, Behxhet Salihu, Afrim Sulejmani dhe Rrahmon Sulejmani... Nazmiu kishte propozuar që udhëheqës i grupit të emerohej Zahir Pajaziti...Po ashtu u mor vendimi që të fomohet edhe Shtabi Ushtarak i Gallabit prej 11 vetash... Mbledhja e parë ishte mbajtur në shtepinë e Faik Ajetit e ku ishin Hajredin Hyseni, Fatmir Humolli, Nazmi Zuka, Ismet Mahmuti, Faik Ajeti dhe Fidaim Gashi.. Aty u vendos që udhëheqja të ndahet në krahun politik me Hajredin Hysenin dhe me Nazmi Zukën krahu ushtarak...
Në mbledhjen e Parë të krahut ushtarak ishte vendosë që të formohej Shtabi Ushtarak i Besianës...
1. Zona e parë përfshinte qytetin e Besianës, përgjegjës Nazmi Zuka
2.Zona e magjistrales Bsianë - Prishtinë, përgjegjës Kadri Pireva..Bllokimi ishte paraparë si gjithnjë te kulina
3. Zona nga Besiana - Bederianë përgjegjës ishte Kadri Pajaziti i Kreshtes. Bllokimi te Liqeni i Batllavës
4. Zonë Besianë - Medianë përgjegjës ishte Gëzim Veseli dhe bllokimi bëhej afër kufirit....
Zahir Pajaziti sipas dëshmitarëve të kohës, në Mbledhjen e Shtabit kërkoi:
"Shtabi duhet të organizohet për aksione kundrr policisë serbe.. Ata po bëjnë torturime ne popull, po plaçkisin dhe lirisht po kalojnë neper fshatra pa asnjë të keqe. Ne duhet t'u dergojmë letra kercenuese policëve dhe shoqeruesve të tyre. Nëse kjo nuk bënë punë atëherë të organizojmë sulme në pusi...Policet serbë të vriten shqiptarët të frikesohen... Disa shqiptarë që po na duken të dyshimtë duhet t'ua bëjmë me dije që të mos bashkë-punojnë me policë... Shtabi duhet të lejojë vrasjen e disa policëve serbë që janë bërë të njohur si kriminelë e sidomos njëfarë Bosanci dhe njëfarë Cipiripi.....
Për të gjitha keto kerkesa Zahiri i la kohë Shtabit, që të konsultohet edhe me pjesën politike... Disa anëtarë të Shtabit i përkrahen qëndrimet e Zahirit dhe u larguan bashkë me të si Isak Shabani dhe Rrahim Haziri.... Që të mos i cekë të gjitha shkaqet po i themë vetëm

dy se perse u largua Zahiri nga Mbledhja dhe perse prej ketij momenti ai e shikonte pak me ndryshe LPRK-ën..
E para disa anëtarë të Shtabit si kishin kryer detyrat e caktuara. këtë Zahiri e kishte vlersuar si Punë jo serioze dhe papergjegjesi sipas rregullave ushtarake dhe e dyta Shtabi i Besianës nuk lejoi organizimin e aksioneve të armatosura dhe kjo u pengua nga udhëheqja politike e LPRK-ës për Besianë...
Pas kësaj u formua Shtabi i Mbrotjes i Zonës së Llapit. Zahir Pajaziti që të ruante sekretin në shkallën më të lartë i dha perkrahjen Nazmi Zukës që të formonte Shtabin e Gallabit... Zahiri për të fshehur punen e tij mori nofken Çerçizi...
Me këtë eme¨r veproi deri saq nuk e pati takimin e parë me Nait Hasanin kur u prezentua me nofkën Ismeti...
Të gjitha keto vertetojnë që në zonen e Llapit vepronin dy Shtabe: njeri i prirë nga Zahir Pajaziti dhe tjetri siç duket ishte i prirë nga Nazmi Zuka...Zahiri vepronte ne të dy Shtabet por nga ky i fundit u largua duke i porositur: Kur te pergaditeni te Zahiri e ke deren e hapur. Kurdo që e keni nevojën me thirrni"... Faktet e me vonshme e kanë vertetuar që pas shuarjes së Shtabit të Besianës anëtarët e tij kanë vazhduar të bashkëpunojnë me Zahirin si ata që mbeten në Kosovë po ashtu edhe ata që shkuan në Shqiperi: Fatmir Humolli dhe Nazmi Zuka…
Burgosjet e vitit 1993 ishin goditje e rëndë për organizimin e luftës çlirimtare. Në vitin 1993 u burgosen kuadrot udhëheqëse (disa nga ato) të LPK-ës dhe LKÇK-ës. Në ketë kohë u burgosen Hajredin Hyseni si Kryetar i Këshillit të LPK-ës dhe dhe dy shoket e tij pergjegjes në rreth: Ismet Mahmuti dhe Faik Ajeti, si dhe Shemsi veseli, i cili ani pse ishte në LKÇK u denua si i LPK-ës..
Në këtë kohë u burgosen edhe: Ahmet Haxhiu, Xhavit Haziri, Ismet Mahmuti, Hajredin Hyseni, Faik Ajeti, Raif Qela, Salih Mustafa, Nehat Selimi, Ramadan Pllana, Islam Mulaku, Ajet Berisha, bajrush Xhemajli, Sanije Aliu, Ramize Abdullahu, Shemsi veseli, Rexhep Avdiu, Skënder Hajdari dhe Hamit Zeqiri...
Zahiri kishte vendosur të kaloi ne aksione konkrete.. Të gjithë shqiptarëve që bashkëpunonin në një mënyrë ose tjeter me serbet së pari u terhiqej verejtja pastaj kalohej në aksione konkrete... Serbet fillluan të ishin më të kujdeshëm ndersa në LLap policia pothuajse u izolua e tëra.. Po ashtu edhe në qytet...

Një serb nga Prokupla kishte sjell një kamion me gjësende. Askush nuk i blente. Një tregtar fshehtas ia bleu tërë mallin. Dy vetë kur u nis kamioni i hodhën tre shishe me benzinë dhe sa doli në rrugë i doli flaka. Fitimin e mori zjarri. Rastet nuk u perseriten më...
Lidhjet në mes Fatmir Humollit, Zahir Pajazitit dhe Nazmi Zukës nuk u nderprenë derisa u vra Zahiri.....
Ushtria Çlirimtare e Kosovës është e arritura më e madhë që kanë arritur shqiptarët e Kosovës...ndersa Zahir Pajaziti ishte njeri nder themeluesit e saj.. Para se të vazhdojë të kthehem vetëm për pak dhe të tregojë një ngjarje që aso kohe kishte bërë bujë të madhe. Ishta dita e 13 shtatorit të vitit 1990 kur forcat policore dhe ushtarake iu drejtuan Pollatës dhe e rrethuan lagjën e Monollëve.
Rrethimi ishte bërë me 20 autoblinda, 70 pizgauerë dhe helikopteri sillej mbi fshat.. Ishin rreth 300 ushtarë e policë serbë...Të gjithë kunder banorëve të një lagjeje. banorët e fshatrave si Fierishtë, Albanë, Revuçë, Metehi dhe Repë dërguan vullnetarë. Ata edhe patën shtënë kundër helikopterit.. Në kodër mbi shtepitë e lagjes ishin vullnetarët nga fshatarta e Mavriqit dhe të udhëhequra nga Muhamet Latifi.. Mbrenda në lagje e patën filluar luftën Besim Hashim Latifi dhe Skënder Hamit Monolli.. Ata luftuan trimerisht deri sa mbeten të vrarë...
Mosmarrëveshjet Bukoshi - Rugova (ky i dyti ishte i predisponuar që çdo gjë shqiptare ta rrenonte) pamundësuan kontaktet e mëtejme dhe grupet ilegale u detyruan të vazhdojnë aksionet me vetëfinancim. Do përmendur edhe këtë gjë që; Ismet Abdullahu vet e ka furnizuar me mjete financiare Zahir Pajazitin pa ndihmen e askujt...
Që të mos zgjatem shumë ngaqë më duket që kjo nuk është edhe aq relevante vetëm do përmendim se; në Gallab Zahiri me një grup shokësh e formoi Forumin Rinor të Partisë Parlamentare ( Adem Demaçi ishte kryetar) dhe në kryesi u zgjodhen njerez të deshmuar në demonstrata... Në zgjedhjet për Gallab me 20 fshatra Zahiri qe zgjedhur Kryetar i PPK...
Zahiri kontakte indirekte përmes Islam Abdullahut, Nazmi Ajetit por edhe të ¨tjerëve kishte edhe me anëtarët e LDKës por siç kishte deklaruar ai; "prej tyre nuk pati as nxitje, as përkrahje, as furnizim me armë dhe mjete financiare.. Ndoshta LDK-ja ka pasur përfitime finaciare dhe politike.

Të gjitha këto e bindën komandant Zahirin se me LDK-ën dhe Qeverin e Kosovës Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka më pse të bisedojë....
Zahir Pajazit ishte në rjedhat e punës së LPK-ës sikurse që udhëheqja e LPK-ës dhe më parë ishte e interesuar me ra në kontakt me Zahirin...Për këtë arsye Ali Ahmeti u lidh në mënyrë direkte me grupin e Llapit, që udhëhiqej nga Komandant Zahir Pajaziti ( duke ju falenderuar Ismet Abdullahut) por edhe kur u krijua lidhja në mes Zahirit dhe Nait Hasanit ishte bërë përmes Abaz Gjukës dhe Ismet Abdullahut...Kjo lidhje pastaj është mbajtur në kuadër të grupi të veçantë të LPK-ës...
Zahiri në Shqiperi disa herë kishte biseduar dhe me LKÇK-ën me Fatmir Humollin që ata të marrin përgjegjsin politike për UÇK-ën. Këshilli i Përgjithshëm caktoi Agron Rrahmanin që të bejnë marreveshje por deri te kjo nuk erdhi...

**Filloi formimi i zonave të lira**

Fillimisht u formuan skuadrat të cilat kishin edhe territorin ku organizonin aksione kundër policisë serbe. Grupet më të organizuara ishin në territorin e Drenicës, të komanduara nga komandanti Adem Jashari, por kishte edhe grupe të vogla të tjera si ai i Rexhep Selimit, i Sylejman Selimit, Sokol Bashotës... Adem jashari u sulmua më 30 janar të vitit 1991. Më 1 janar 1992 shkuan Ramiz Lladrovci dhe Jakup Krasniqi të njiheshin me situatën. Ata biseduan me Shaban Shalën dhe vendosen që të krijohej baza ushtarake në shtëpinë e tij...Aty u vendosën: Ademi, Hamza, Rifati dhe Sahit Jashari, Fadil Kodra dhe të tjerë kështu që deri më 22 janar 1998 fshati Prekaz ishte zonë ushtarake ku policia serbe nuk arriti të hynte...Në Klinë ishte Mujë Krasniqi që i përkiste Zonës Ushtarake të Drenicës, i cili ishte i lidhur me Rexhep Selimin..
Zahir Pajaziti kishte kontakte direkt me Adem Jasharin por edhe permes Rexhep Selimit. Zahir Pajaziti kishte shkuar në Prekaz por edhe Ademi kishte shkuar në Llap dhe për këtë tregon vetë Musë Jashari...
Zahiri kishte krijuar lidhje edhe me grupin e Radafcit, nabërgjanit etj. Në grup kanë qenë Qerim Kelmendi pastaj Adrian Krasniqi. Por grupet padyshim më të organizuara në atë kohë ishin në Drenicë dhe në Llap... Nuk duhet harruar që në Dukagjin Zahiri kishte shkuar edhe në Gllogjan..

**Një episod**

Zahiri e kishte një pistoletë shumë të mirë, e cila kurrë nuk kishte dështuar me rastin e atentateve të bëra. Luani e pelqeu këtë pistoletë, të cilën Zahiri ia dhuroi. Pas lufte vellezrit Haradinaj Ramushi, Dauti dhe babai i tyre e ftuan Qerim Pajazitin, babain e Zahirit dhe ia kthyen pistoletën. fatkeqësisht Zahiri dhe Luani bartesit e asaj pistolete tani ishin të përjetsuar ashtu siq ishte edhe Shkelzeni vellai i Luanit...

Në grupin e Drenic vepronin edhe Rexhep Selimi...

Por duhet cekur këtë gjë. Për nevojën e formimit të Ushtrisë ishte biseduar edhe në radhët e LPRK'ës dhe në Zajaz ku merrnin pjesë në Një Mbledhje Konsultative: Ahmet Haxhiu, Azem Syla, Hashim Thaqi, Ali Ahmeti, Adem Grabovci, Gafurr Elshani, Sahit Berisha, Ibish Neziri, Ramadan Avdiu, Fatmir Brajshori, Behxhet Luzha, Halil Selimi, Hidajete Krasniqi, Hysen Gega, Beajdin Allaqi.. u krijua Grupi për organizimin e Mbledhjes së IV-të i përbërë nga Hashim Thaqi, Bilall Sherifi dhe Adnan Asllani...

Mbledhja e katërt ishte mbajtur në Prishtinë dhe aty mirrte pjesë edhe krahu ushtarak kështu që në fund të saj (zgjati dy ditë ndersa delegatët ishin të siguruar ngaqë ishte vërë rojë e armatosur përreth) ishte vendosur të forcohej puna per organizimin e aksioneve luftarake...

Dhe më 26 dhe 27 skorrik të vitit 1993 LPRK-es iu ndërrua emri në Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) dhe u morë vendimi kurcial formimi i Ushtris Çlirimtare të Kosovës!

Por megjithate kur jemi te Zahiri do duhet cekur këtë gjë: Ai nuk ishte i kenaqur me punen e subjekteve politike të Kosovës, qofshin ato ilegale apo legale.. Kështu që ai ka pas ferkime të shumta edhe me LPK-ën e LKÇK-ën...

UÇK-ja u formua dhe për emertimin e saj ka disa versione... Për mua qendron ajo që është thënë edhe më herët që; me 17.11.94 iu vu emri si UÇK-ë në Arau të Zvicres... Unë do permendi vetëm disa nga ato variante...

Sipas Musë Jasharit fjalën e parë Ushtri Çlirimtare e Kosovës e kishte dëgjuar prej Adem Jasharit... Izeir Mustafa gjatë stervitjeve ushtarake në Besianë në bisedë me Rrahim Hazirin vendosin që t'i thonë Zahir Pajazitit që grupet tona t'i quajmë Ushtria Çlirimtare e Kosovës...

Kur e kishin thirrur Zahirin nga Zvicra Islam Abdullahu dhe e kishte informuar se ishte vendosur per emrin Zahiri qe pergjigjur: Emër i

madh qenka! Me fat! Emri nuk ka rëndësi por puna duhet bërë. Kosovën do ta çlirojmë"
Zahir Pajaziti kishte një veti të lindur që të mendojë shumë dhe të flet pak. Në të parë ishte i qetë dhe kurrë nuk ngutej në vlerësime. mendonte analizonte edhe pastaj e jipte mendimin dhe ai ishte i prerë, i qartë dhe mobilizues...Nuk pinte duhan dhe as alkool. hante pakëz bukë, por më shumë pemë". Për shaka njëherëi tha një shoku:
„Ore, a e din çka i ka thënë nëna e Azem Bejtës një njeriu që kishte shkuar t'i bashkangjitej djalit të saj në luftë? Shko, në shtepi, se Azemi një javë jeton me atë që hangre ti në një vend!"
Ai, Zahiri ishte një konspirator i vërtetë. Nuk kishte lejuar as edhe një herë që dikush të mund të kuptonte ndonjë gjë nga Ay e që nuk ishte e domosdoshme...Të gjithë luftetarët e Grupit të Zahirit kanë pasur pseudonimet. Zahiri ka pasur shumë pseudonime por per shokët e Shtabit të Përgjithshëm ka qenë i njohur me ISMETI. Pastaj Iliri e kishte nofkën - Mërgimi, Rrustem Mustafa - Njëshi, Selim Haziri - Dyshi e kështu me radhë...
Sulmet e para në Zonën Operative të Llapit janë organizuar që nga viti 1981, kur ushtari i parë serb vritet në afërsi të Besianës dhe në arkivol e kthejnë në Beograd. Ato aksione u intensifikuan në kohën e Çetës së Llapit dhe ky kontinuitet është ruajtur deri në "çlirimin" e Kosovës në vitin 1999...
Zahir Pajaziti organizoi aksionet e armatosura në ZOLL. Ai jo vetëm që organizoi, por edhe vetë mori pjesë në aksione të armatosura. qË NGA VITI 1992 DERI NE VITIN 1997 KISHTE ORGANIZUAR SHUMË AKSIONE DHE VETËM NJË HERË AI NUK ISHTE KRYER sipas planit, sepse fisheku dështoi, nuk ndezi dhe Sredoje Radoviqit - Cipiripit iu zgjat jeta edhe për dy vjet. Kjo kishte ndodhur në shtator të vitit 1994. Të gjitha të tjerat ishin kryer me sukses.. Cipiripi ishte njeri nder policët më kriminel, i cili bëri tortura të shumta në rajonin e Llapit dhe të Gallabit.. ndër ato familje që ishin torturuar ishte edhe Familja e Qerim Pajazitit, babai të Zahirit. Ishin rrahur në Gallab Qerimi dhe Agimi, vellai i vogël i Zahirit, pastaj te varrezat e fshatit Albanik Qerimi dhe Bajrami, vëllai i madh i Zahirit. Aty policia së bashku me cipiripin i kishin lënë si të vdekur..
Në shtabin Qendror të UÇK-ës kishin bërë planin që më 27 shtator 1996 të kryejnë dy atentate: në një Besianë dhe tjetri në Runik të Drenicës..

Zahiri kishte kerkuar që Atentatin në Cipiripin ta kryente vetë dhe ne mbremje erdhi kusheriri i tij Fadil Pajaziti. Ai e informoi se Cipiripi ishte në një kafene afër Shtepisë së Shendetit ne Besianë.. Zahiri pergaditi automatikun dhe revolen e futi ne brez dhe aty e gjeti Cipiripin në të cilin shtiu me një karikator të cilin e zbrazi në trupin e tij.. Në trup i mbeten 14 plumba.. Qytetarët e Llapit u liruan nga ky kriminel...
Ky atentat pati jehonë të madhe në tërë territorin e Kosovës...
Atentati tjeter i Zahirit, bashkë me Ilir Konushevcin është kryer kundër Millosh Nikoliqit nga fshati Surkish, inspektor i Ministrisë së Punëve të Mbrendshme të Serbisë, me 27 tetor 1996. Atentati u krye afër shtepisë së tij në Surkish, ku mbeten të vrarë Millosh Nikoliqi, më i njohur si i " biri i Dragqit" dhe Dragan Rakiq nga fshati Katunishtë. bashkë me Zahirin ka qenë edhe Ilir Konushevci. Në veturë për në Surkish kanë qenë edhe Selim e Naim Haziri dhe Naim Hyseni.
Aso kohe në mesin e ilegales por duke shperthyer ngadalë edhe të popullata ishin keto fjalë:
Nikoliq more shka
Edhe në hypsh në shtat kala
Dora e Zahirit ka me të vra.
Dhe me të vertet ashtu edhe ndodhi...
Atentati më i organizuar është bërë kunder Radivoje Papoviqit, rektor i dhunshëm i Universitetit të Prishtinës, i cili i përjashtoi studentët shqiptarë nga objektet e tyre, dhe u dëshmua, si armik i përbetuar i popullit shqiptarë. Atentati ishte i organizuar mirë, në mënyrë profesionale me " autobombë", aktivizimi i së cilës u bë nga largësia..
Vetura "autobombë" ka qenë e Ilir Konushevcit kështu që ai vetëm disa ditë më herët, e kishte shpallur, se vetura e tij ishte vjedhur... Në këtë aksion kishin marrë pjesë shumë veta por padyshim nder me të angazhuarit kanë qenë Hakif Zejnullahu dhe Ilir Konushevci... Në këtë kohë, vetëm pak ditë më herët, Zahiri ishte nisur urgjent për Tiranë, kështu që në kohën, kur u bë shperthimi, ai gjendej në Shqiperi...
Organet e policisë serbe, në veturen " autobombë" zbuluan numrin e shasisë, me të cilën u dëshmua, se pronar i saj ishte Ilir Konushevci dhe kjo ishte e mjaftueshme, që të hapej procedurë e ndjekjes penale...
Por, nga dita kur vritet Zahiri, Iliri me disa shokë, kaloi në ilegalitet dhe dy javë më vonë, ilegalisht kaloi në Shqiperi...

Po ashtu, u kry një atentat në inspektorin tjeter të Policisë serbe, udbashin shqip-folës Ejup Bajgorën nga fsahti Lupq i Poshtëm… Ky udbash famëkeq, në lokalet e sigurimit serb në Prishtinë, pa nderprerë maltretonte të burgosurit; qofshin ata pleqë, gra apo edhe të rinjë… Ky inspektor kishte maltretuar sidomos të burgosurit e vitit 1993 dhe një nga ata që nga torturat e tij kishte pësuar dridhje në tru ishte edhe Fatmir Brajshori. Ai (Udbashi famëkeq Ejup Bajgora), ishte përcjellur tërë kohën në Prishtinë dhe në momentin, kur ai kishte marrë autobusin Podujevë – Prishtinë,. me të zbritur te stacioni i Lupqit, vetëm pak hapa sa i bëri, u vra nga atentatorët motociklistë, e që ishin dy veta... Duhet thënë që njeri ishte nga një Zonë tjetër e Luftës.... Për momentin kjo mbetet kështu...

Zahiri e kishte ruajtur me ditë të tëra edhe gjyqtaren Danica Marinkoviqin, një kriminele serbe e cila bënte kërdinë, në ato vite ndaj shqiptarëve, e sidomos ndaj të burgosurve, të cilët vetë i merrte në pyetje nën dhunen policore... Gjatë atyre ditëve, Zahiri shëtiste rrugëve të Prishtines me bombë në xhep, pa siguresë, që në momentin, kur të ndeshet me të, ta aktivizojë... Te Zahiri e them me plot bindje, aq shumë ka qenë e ngulitur urrejtja ndaj kësaj krimineleje, sa që, po t'i jipej edhe mundesia më e vogël, ai bashkë me të, do ta hedhte edhe veten në ajër, veq ta kryente atë, që e kishte planifikuar, për ta kryer...

Për sulmet që ishin bërë në Stacione të Policisë, pasi per to kam folur dhe shkruar në një artikull gazete , veq shkurtë..

Më 2 gusht sulmohen këto stacione të Policisë...

**Në Besianë - Zahiri dhe Avni Ajeti - Sokoli**

Stacionin e policisë në llapias e kanë sulmuar Sejdi Rama dhe Shukri Ismajli... me veturë i kishte derguar Hakifi...

Stacionin e policisë në Llabucë e sulmuan Rrustem Mustafa - remi dhe Muharrem Ismajli

Stacionin e policisë në "Mahallen e Muhagjerëve" u sulmua me bomba ashtu si e kishte paraparë Ilir Konushevci dhe Selim Haziri...

Shtabi Qendror dëshironte të informojë diplomacinë e shteteve perendimore, se në Kosovë është formuar ushtria dhe ajo nuk ishte organizatë terroriste por ishte Ushtri Çlirimtare, e cila lufton dhe do të luftojë në të ardhmen deri në çlirimin e tërë territorit të Kosovës...

Komunikatat i mori mbi veti Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe pastaj Shtabi Qendror i UÇK-ës përderisa Zahiri ishte në krye të tij.

Komunikatat e para janë shkruar në Kosovë dhe pastaj ato janë dërguar në vende të tjera dhe u janë adresuar mjeteve të informimit.
Nga ata që kanë mbetur gjallë, por që kryesisht e kishin selinë jashtë vendit e që herë - herë ktheheshin në Kosovë, ka mendime se komunikata e parë mbante nr.7, por si komunikata komplete janë botuar nga komunikata nr. 13, e nënshkruar nga UÇK-ja. Ekzistojnë të dhëna që komunikata e parë është hartuar në Zvicër nga sektori i veçantë në përbërje: Azem Syla, Xhavit Haliti, Emrush Xhemajli dhe Ali Ahmeti.
Lidhur me lëshuarjen e komunikatave, ekzistojnë edhe të dhëna, se janë hartuar në Prishtinë dhe me sugjerime e për konspiracion janë dërguar edhe në Qendër në Zvicër dhe se ato kanë filluar nga numri 1, dhe se janë dërguar përmes telefonit nga Teatri Kombëtar. Aty punonte Bajram Zejnullahu, i vëllai i Hakif Zejnullahit. Këto Komunikata i ka dërguar Zahir Pajaziti. Kjo e dhënë nuk është përgënjeshtruar nga askush deri  më tash, por as nuk është konfirmuar.
Se Zahir Pajaziti ishte komandant i parë i Shtabit Qendror të UÇK-ës, konfirmon edhe Qerim Kelmendi, i cili veç të tjerash shton: "Zahir Pajaziti ka qenë figura qendore e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës...
Xhemë Jakupi nga Shishmani i Gjakovës thotë:
"Zahiri ka ardhë në shtëpinë time me shumë shokëtë tij. Mirëpo, një mund ta them: se asi djali nuk kam parë asnjëhrë, dhe sigurisht për këtë ai ishte në krye të tyre"..
Të përfundojmë këtë mendim: Zahir Pajaziti ishte komandant i parë i Shtabit Operativ - Qendror të UÇK-ës në periudhën 1993 - 1997 dhe komandant i Shtabit të Zonës Operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**Bazat ushtarake**

Zahiri në disa baza ushtarake i kishte në fshatin Gallab pastaj në Kreshtë, në Lugëz, në Ballaban dhe në Hertizë. Asnjëra nga këto baza asnjëherë nuk është dekonspiruar.
Në rajonin e Llapit ka pasur disa baza në Gurash, në shtëpinë e Sabit Zejnullahut, në Balsh në shtëpinë e Enver Osmanit, në Bardhash, në Pollatë në shtëpinë e Muhamet Latifit, në Buzëllap në shtepinë e Çelë Gashit dhe Latif Gashit, në shtëpinë e Rrustem Mustafës në Besianë, në shtëpin e dajës së Avni Ajetit në Besianë, në Vinden, shtepia e Zahirëve në Kolaj dhe ndonjë tjetër për të cilat kanë qenë të njohur Zahiri dhe Hakifi..

Në Prishtinë, bazë ushtarake ishte shtepia e Isak Shabanit në Kodër të Trimave, në Shtëpinë e Shaip Hazirit e një bazë e ka patur Ilir Konushevci dhe atë e kanë ditur vetëm Zahiri dhe Iliri Luftetarët e UÇK-ës pas kryerjes së aksionit shkonin në baza të kunderta nga vendi i kryerjes së aksionit.Nëpër baza janë vendosur natën dhe ditën nuk kanë bërë lëvizje..
Baza Ushtarake ka pas formuar në ZOLL edhe Ahmet Haxhiu si në Dyz, në Koliq, në Venedis por edhe në Prishtine.
Zahiri në Prishtinë ka qëndruar një kohë në shtepinë e Isak Shabanit e pastaj në një shtëpi që e ka marrë me qira në rrugën e Vushtrrisë. Por Zahiri më së shpeshti është strehuar në Gurash te Sabit Zejnullahu, pastaj në shtepinë e Ali Ahmetit në Gallab, te dajtë e tij në Herticë, por edhe në Batllavë të Bejtush Maliqi, në Llapshticë të poshtme në shtepinë e Rashid Muratit, në Besianë i ka pasur dy shtepi ku është strehuar: njera ka qenë e Sylejman Nezirit...
Në fshatin Bajgorë ka qëndruar vetëm dy herë dhe atë në shtepinë e Ramë Ukës, babai i Mehë Ukës. Heren e parë ishte me rastin e vizitës së kullës së Isa Boletinit dhe herën e dytë për të analizuar kushtet për formimin e grupit të UÇK-ës në Shalë të Bajgorës nga fundi i gushtit të vitit 1996. Zahiri nga Mehë Ukaj mori një lidhje të sigurt në anën e Vrrinit, familjen Badallaj, që ishte me rendesi për shkuarjen në Shqipëri. Por, kjo lidhje nuk është shfrytezuar.
Zahiri shkoi për Shqiperi, kurse Mehë Uka u vra më 29 dhjetor 1996...
Zahiri Burgoset në Shqipëri
Pas formimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye të detyrës shkoi edhe në Shqipëri. Shkuarja e tij në Shqiperi është e lidhur edhe me nevojat e UÇK-ës për armë dhe municion.. Në Tiranë ka biseduar edhe me njerëz që punonin në Gjermani dhe Zvicër, që ishin nga Rajoni i Llapit per sigurimin e mjeteve finaciare, për nevojat e organizimit të luftës çlirimtare në Kosovë...
Zahir Pajaziti forcat politike, partit politike pa dallim i donte ë bashkuara dhe ato duhej t'i jepnin përkrahje politike UÇK-ës. Zahiri lidhjet me udhëheqsit e LKÇK-ës i kishte që nga fillimi me Nazmi Zukën dhe nëpermjet tij, një kohë edhe me krahun ushtarak të LPK-ës, kur Hajredin Hyseni ishte kryetar për rethin e Llapit. Zahiri në Shqiperi takohej me udhëheqjen e LKÇK-ës Fatmir Humollin, Nazmi Zukën, Sabit Gashin dhe të tjerë. Në tetor të vitit 1995 Zahiri ishte në

Shqiperi dhe shfaqi interesim të Takohej me prfaqesusin legal të LKÇK-ës SEJDI VESELIN. Takimin e mundesoi Nazmi Zuka.
Në prill të vitit 1994 Zahiri qëndroi në Shqiperi gati një muaqj dhe vendosi të kthehej në Kosovë. Afër kufirit e zuri roja e Ushtrisë Shqiptare dhe u burgos. Për nevoja të Ushtrisë Zahiri kishte marrë 18 bomba në Shqipëri. Në burg e mbajtën 30 ditë, ku pastaj u lirua. Aty ia hoqen në tërësi flokët dhe vuajti burgun në kushte shumë të rënda. Anëtarët e LKÇK-ës Fatmir Humolli dhe Nazmi Zuka dhe shokë të tjerë u angazhuan për lirimin e tij, ATA E DERGUAN EDHE BAHRI BRISKUN TË INTERVENOJË TE SALI BERISHA, POR PUNA NUK U KRYE NGAQË BERISHA NUK I APROVONTE VEPRIMET QË DILNIN JASHTË POLITIKES SË LDK-ËS DHE IBRAHIM RUGOVËS....NË AKTAKUZË THUHEJ SE" mirrej me veprimtari të ndaluar për shtetasit shqiptarë".
Zahiri oficerit shqiptarë i kishte thënë: "SA TË MË MBANI JU NË BURG, AQ MË LARG ËSHTË LIRIA E KOSOVËS".
Burgun e vuajti në Bajram Curr.
Zahiri në Shqiperi ishte takue me Ismet Abdullahun dhe me Nazmi Ajetin...Ata biseduan për UÇK-ën dhe për mjetet finaciare. Nazmi Ajeti e luti Zahirin që Avniun, vëllain e tij, ta inkuadrojë në UÇK-ën dhe bashkë të kthehen në Kosovë. Nga kjo kohë Avni Ajeti - Sokoli nuk u nda nga Zahiri deri në ditën e vrasjes së Zahirit. Pas vrasjes së Zahirit së bashku me Ilirin kaloi në Shqiperi, U kthye në Kosovë së bashku me Remin, kur shkoi në Shqiperi për furnizimin e ushtarëve të tij në Zoll.
**Avniu ishte në njësitin "KOBRA" që nga formimi i saj...**
Në vitin 1997 nga shumë shkuarje-ardhje Zahiri kthehet në Kosovë..Për aksione konkrete dolen me qendrimet e tyre Ilir Konushevci për Prishtinë dhe Rrustem Mustafa Remi për Llap.. Zahiri kishte planifikuar të thërras edhe mbledhjen e Shtabit Qendror të UÇK-ës. Mirepo më 25 janar 1997 ishte burgosur Nait Hasani.. Zahiri Ilir konushevcin, Isak Shabanin dhe Shaip Hazirin, i njohtoi në lokalin e Ilirit se ishte burgosur një shok i tij shumë me rëndësi...
Po të njejten ditë në orën 16 u takua me Bislim Zogajn në stacionin e autobusëve në Prishtinë dhe sa u nda nga Zahiri arrestohet, kurse Zahiri, Hakifi dhe Edmondi vriten në Pestovë vetëm 20 minuta më vonë..

Burgosjet e vitit 1997 filluan. U burgosën 100 veta, mirepo padia u ngrit kundër 17 të akuzuarve. Nait Hasani, Agron Tolaj, Arif Vokshi, Hasan Zeneli, Qerim Kelmendi, Alban Neziri, Agim Makolli, Hamzë Pangjaj, Asllan Selimi, Eqrem Kastrati, Isak Shabani, Bislim Zogaj, Ilir Gashi, Ali Gjuliqi, Demir Limaj, Agim Hulaj, Selim Lokaj, Hajdin Rama dhe Nezir Zogaj... Gjykata i denoi prej 4 deri në 20 vjet burgë (Nait Hasanin)... Qerim Kelmendi u denua me 15 vjet burg në mungesë (arrati) dhe Hamzë Pangjaj u gjykua më 13 vjet në mungesë( arrati) të cilët nuk arritën t'i burgosnin...
Gjatë këtyre arrestimeve u prangos edhe Besnik Restelica i cili ishte shok i pandashëm me Asllan Selimin. Më 31 janar policia e rethoi shtëpin e Besnikut dhe e arrestuan, bashkë me shokun e tij Sylejman Jasharin nga Bardhashi, të cilin pas 5 dite e liruan. Besniku mbeti në burg në hetime në Prishtinë... Ai iu nenshtrua torturave nga më të ndryshmet. Kur nuk arriten për të zbuluar asgjë policët e shtuan dhunën dhe më në fund e vrasin.. Në trupin e tij janë zbuluar gjurmët e tre plumbave të shkrepur nga afërsia. Besniku është vrarë më 22 shkurt 1998, në burgun e Prishtinës. Policia familjen e tij e lajmeroi më 23 shkurt 1998, kinse Besniku, në burg e ka mbytur veten. Besniku u varros me 24 shkurt 1998, me percjellje të disa mijera shqiptarëve, në varrezat e Besianës.. Në varrim fjalim mbajtën Ilaz Pireva dhe Hydajet Hyseni...
Në Zërin e Kosovës, Fatmir Brajshori boton tregimin me titull: “Qëndresa” kushtuar pikrishtë Besnik Restelicës,,, Besniku ashtu siç e kishte emrin, mbeti BESNIK i përjetshëm i idealeve të tij; për liri dhe Bashkim Kombëtar...
Profetët qysh herë e kishin thënë që dita e premte është ditë e shënuar. Por çka ndodhi në një të premte në Kosovë, në Prishtinë dhe në Pestovë? Dita e premte e 31 janarit e vitit 1997? Ishte ditë e Ramazanit.
Klasa politike kërkonte të zbuloheshin autoret e ketyre aksioneve. Para dite në Lokalet e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Partia që i mbante atë si seli të veten dhe prijesi i asaj partie IBRAHIM RUGOVA, kërkonte:" zbulimin e autorëve, kërkonte qetësi, durim dhe zgjidhje tjeter nuk shihte, pos një lëmsh me fije të humbur.Meteorologen thonin se dita do të jetë shumë e ftohtë... Këto ishin shËnuar në kronikat të botuara nëpër gazeta në Prishtinë. Por ato gazeta nuk e shenuan thenjen e Zahirit: " DIELLI PO NXEN

NË PRISHTINË", ku më 1993 ishte Formuar Shtabi Qendror i UÇK-ës punët e morën të mbarën...
Në veçanti u vlersua sukses atentati me autobombë i kryer 15 ditë më parë në Prishtinë...
Zahirin dita e premte e gjeti në Prishtinë. Atë natë u qua në syfyr dhe pastaj vazhdoi të pushonte edhe një kohë, sepse sipas planit e kishte shumë punë dhe detyra që duhej kryer brenda dite...
Sa doli në derë u ndesh me policinë. Kjo ishte episoda e parë e ditës. Me gjakftohtësi u kthye prapa - në banesën e tij në Tophane. E mori telefonin dhe i thirri shokët, që ti vijnë në ndihmë. Ata u përgatitën dhe të prirë nga ILIR kONUSHEVCI E TË ARMATOSUR, I SHKUAN NË NDIHMË. KUR U AFRUAN VëREJTëN, SE POLICIA E KISHTE RRETHUAR NJË SHTËPI TJETËR DHE BËNIN BASTISJEN E SAJ. ATA, E LAJMERUAN ME TELEFON, SE AI MUND TË DALË, SE POLICIA ËSHTË DUKE E BASTISUR fqiun e tij. Pas kësaj informate Zahiri doli dhe vëtëm dy tri metra larg policëve kaloi, por nën përkujdesjen e shokëve. Shkuan në një çajtore afër derës së tregut dhe u ulën në katin e parë. Zahiri, Iliri, Shaip Haziri dhe Beqir Beqiri. Pastaj erdhi dhe Isak Shabani. Më parë i kishte telefonuar edhe Hakif Zejnullahut në Gurash që rreth orës 12 të vjen në Prishtinë....dhe të takohen në vendin e caktuar...
Hakifi erdhi dhe e parkoi veturen në rrugën e Vushtrrisë ku ishte parkuar edhe vetura e Ilirit dhe u gjend në çajtoren e Ilirit bashkë me shokë si e kishte informuar..Ekziston dyshimi se dikush e kishte lajmeruar policinë për Banesën e Zahirit në Tophanë, por nuk e kishte ditur me saktësi se cila shtëpi ishte. Policia e bastisi shtëpinë, nuk gjeti asgjë. Nuk e torturoi askend. Nuk e mori me vete asnjeri nga shtepia e bastisur. Këto të dhëna vërtetojnë për mundësinë e dyshimit të bazuar se ishte kërkuar banesa e Zahirit për arrestimin e tij…
Në çajtore të Ilirit më 31 janar u gjeten për herë të fundit Zahiri me shokët e tij luftëtarët e tij të zgjedhur. Dhe, ishte hera e parë dhe e fundit, që Zahiri fliste në një grup kaq të madh. Zakonisht bisedat i bënte në mënyrë individuale ose me ata që duhet të kryenin aksionin. Shokëve u tregoi: Një shok i yni është burgos, por nuk e permendi emrin e tij… Të gjithë kishin frikë se mund të rrezikohej edhe Zahir Pajaziti, por edhe të gjithë shokët. Mirepo, Zahiri foli me gjakftohtesi të madhe.. Zahiri me këtë rast u tha shokëve se një kohë të gjithë

duhet të kalonin në ilegalitet të thellë, të mos qendronin dhe të mos kthenin nëpër shtepiat e tyre.
Kjo ishte porosi dhe detyrë që u kishte dhënë komandanti Zahir Pajaziti!!!
Po ju tregojë vetëm një episod të shkurtër edhe pse po dal nga Tema: Ahmet Haxhiu - Plaku ( baca) kishte filluar kudo që të ketë mundësi të mblidhte armë dhe të krijonte bunkerët... Njëherë ia kishte dhënë një sasi armësh N.N ( nuk është me rendësi kjo) nga Llapi për t'i strehuar armët.. Personi që i kishte marrë armët nga frika që keto po i zbulohen, i kishte groposur në tokë.. Kur baca shkon për t'i marrë armët, N.N i thotë: " Sonte s'mund t'i jap se i kam futur në dhe..." baca Ahmet i thotë: Po, pse bre burrë nuk më ke çu fjalë e me ardhë e me i marrë para se ta bash këtë punë" e qorton Baca
Kur i merr armët duke i kontrolluar i pastron e i lyen sipas rendit, por disa nga ato kishin marrë korizion. Ishte hera e parë që SHOKËT e kishin parë bacën të ligështohej. I panë lotët që i rodhën nëpër fytyrë dhe i pikuan mbi armët amanet - brezash...
**Vazhdojmë me Zahirin**
Iliri ia kishte dhënë njeriut të caktuar që të përdorej makina e tij si veturë " autobombë" për të vrarë Papaviqin... Atentatori kishte dhënë sigurime se vetura do të shkatrrohej në tërësi dhe kurrë nuk ka mundesi të ndiqej ndonjë shenjë. Por, gjatë hetimeve policia e kishte gjetë numrin e shasisë së veturës. Kjo ishte e mjaftueshme që policia të hetonte hetimet për Ilirin. Policia kishte biseduar se mos Iliri kishte dyshimet e tij se kush ia kishte vjedhur veturën. Iliri ishte pergjigjur:Kur të humbë malli të humbë edhe shpirti. Unë, dyshoj në të gjithë qytetarët derisa të gjendet vetura, por nuk mund të tregoj me gisht për askënd...
Për të gjitha keto Iliri e kishte lajmëruar Zahirin. Më 29 Zahiri dhe Iliri kanë biseduar me njeri tjetrin dhe ky i pari i kishte thënë se duhet të shkonin në një detyrë të rëndësishme...
**Cila ishte detyra e veçantë?**
Dihet se rruga që mori Zahiri ishte për në drejtim të Vushtrrisë. Por, nuk mund të konfirmohet se ishte deri aty apo ishte për në Mitrovicë.. Supozimi i parë ndoshta do të mund të ishte se ishin nisur për të vrarë komandantin e tmerrshëm të policisë - Vuçina, kriminel i deshmuar por per Zahirin kjo gjë nuk paraqiste ndonjë gjë të madhe...ishte sprovuar ai nëpër vite për aksione të tilla....

Ajo se si ishte ndryshuar plani, që edhe Iliri të mos ishte me ta, në veturë besoj që e keni lexuar dhe ditur sikurse edhe takimin e tij me Bislim Zogajn te stacioni i Autobusave, ku po sa ndahet Bislimi nga Zahiri, menjeherë prangoset ndersa Zahiri vetëm gjysmë ore më vonë vritet...
Ajo që është dhe sot e kesaj dilemë është se si e ka pergaditur policia të " ashtuqujturen " përcjellje japoneze" e cila nënkupton, përcjellje nga ajri me helikopter, mjetet e blinduara të fshehura dhe policia në pritë në të dy anet e rrugës... Po ashtu thuhet se dikund nja tri orë më herët, policët i kanë detyruar banorët e fshatit Pestovë, të hynë mbrenda në shtëpia dhe të mos tentojn të dalin nga aty...Pastaj kjo vrasje ka lënë shumë dilema nder te cilat është ajo; se si u identifikua makina dhe si ishte e mundur që pikerisht kjo makinë të bjerë në prit të policisë... Përleshja ka ngjarë pak pas orës 16°°...
Po atë ditë, pra më 31 janar ( ditë e premte kur vetëm pak orë më heret në Konferencen e Rregullt të Rugovës për shtyp ishte kerkuar të zbulohen akterët e vrasjeve " enigmatike dhe kurdisjeve të bombave") të vitit 1997 bijn në fushën e nderit Komandant Zahir Pajaziti së bashkë me shokët e tij: Hakif Zejnullahun ( me Hakifin ishin dajë e nip) dhe Edmond Hoxhën!!!
E para që i kishte identifikuar ishte një infermiere mnga Gurashi e cila e kishte njohur kufomën e Hakifit kështu që ajo e kishte lajmeruar me telefon Fixhrijen, motrën e Hakifit, e martur për Ismet Hazirin djalin e Kadrisë nga Muhazopi dhe me vendbanim në Prishtinë...
Ajo pastaj lajmeroi nëpermjet vjehhrrit të saj Kadriut, Sabitin dhe kështu ky lajmë i kobshëm, jehoi kudo nder shqiptarë të ndershëm dhe të devotshëm, për çështjen tonë Kombëtare...
Varrimi ishte bërë më 1 shkurt dhe Familjet ishin marrë vesh që Zahiri të varoset në ora 13°° ndersa Hakifi në ora 15°° kështu që të kishin pasur mundesi të mernin pjesë të gjithë ata që ishin të interesuar në të dy varrimet...
Gjatë Luftës së Haptë dhe heroike që bëri ushtria Çlirimtare e Kosovës u formua edhe një Brigadë së cilës emri iu vu emri : Brigada 151 "Zahir Pajaziti"…
Dëshmorë të kësaj brigade janë: Isa Havolli, Avni Selmani, Fatmir Selmani, Bajram Murati,Rushit Selmani, Adnan maliqi, Jusuf Pallomi, Shefki Kuleta, Raif babatinca, Sahit babatinca, Tefik babatinca, Halim Statovci, Hajdin haliti, Mehmet Visoka, Shaban Avdiu, Muhamet

Sokoli, Raif haliti, Murat Murati, Behar Begolli, Mentor Retkoceri, Esat Berisha, Enver maloku, Ibrahim Krasniqi, Bekim Maliqi, Belim Lushaku, habib Zeka, Fadil Sejdiu, Nazmi Zhegrova, Islam Rekaliu, Selim Rekaliu, Skender Zejnullahu, Miftar zejnullahu, Lulzim Jashari, Remzi Demolli, Jetullah Kastrati, Driton Azemi, Ismet Beqiri, Nazmi Ismaili, Fatmir Selmani,Hamdi Sejdiu, Ragip Ademi, Shemsi Isufi, Bekim mani, Ferat Aliu, Sami Plakolli, Bedri Bislimi, Fazli fetahu, Mirsad Gashi, Shahin Gashi, Eset Maloku, Bedri maloku, Fatmir Hyseni, Skënder Gashi, Behram behrami, Avdyl Nimani, Emin Sinani, Hasan Jasha, Milaim Qerimi, Musa Qerimi, Ilaz Selimi, Ahmet Shabani, Abit Sinani, Hasan Dema, Jetullah Islami, Sali Qerimi (nëse e kam harruar ndonjerin Ata s'do t'i harrojë kurrë Toka e Kosovës... por as edhe shokët e tyre kështu që mund ta plotësojnë këtë gjë....)
Këtu nuk i shkrova Eprorët dëshmorë, Dëshmorët e gardës, BIA-s, Të Brigadës 153 " Hyzri Talla" por vetëm Ata të Brigadës së 151 " Zahir Pajaziti...

_____

Burimi:

° ARKIVA e Lëvizjes Popullore të Kosovës,
° Dr. Fehmi Pushkolli: Zahir Pajaziti-Hero i Kombit,
° Gazeta 'Zëri i Kosovës', 'Koha Ditore' dhe 'Epoka e Re',
° Bashkëluftëtarët e Zahirit,
° Arkiva e ZOLL dhe Burime tjera…